



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

Në pajtim me nenin 132 dhe 133 të Kushtetutës të Republikës të Kosove, Ligjin nr. 05/L -019 për Avokatit e Popullit, Rregulloren nr.01/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, Rregulloren e punës në Institucionin e Avokatit të Popullit nr.02/2016 dhe Rregulloren nr.02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionit të Avokatit të Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

**K O N K U R S**

për plotësimin e vendit të lirë të punës

**Titulli i vendit të punës:**

**Lektor dhe redaktor**

Numri i referencës:

6/2018

Grada/Koeficienti:

Niveli Profesional – G6/11.29

Mbikëqyrësi:

Udhëheqës i divizionit për shërbime të përbashkëta/

Kohëzgjatja e emërimit:

Pa afat, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1(një) vjeçare.

Vendi:

Prishtinë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:**

1. Redakton dhe lekturon me shkrim materiale dhe dokumente të IAP;
2. Redaktim i atypëratyshëm i dokumenteve dhe i shkresave të IAP;
3. Përkujdeset për strukturën e fjalëve dhe të fjalive në dokumentet e përkthyer;
4. Ndhmon në përcaktimin dhe në harmonizimin e terminologjisë gjuhësore për tekstet e përkthyer;
5. Mirëmban sistemin e arkivimit të materialeve të redaktuara dhe të lekturuara në mënyrë korrekte dhe të besueshme;
6. Ndhmon në përpilimin e terminologjisë së standardizuar ligjore dhe administrative;
7. Ndhmon dhe shoqëron përkthyesit dhe zyrtarët tjerë lidhur me përdorimin e drejtshkrimit në shkresa dhe dokumentet tjera;
8. Harton raporte të punës në baza mujore, tre mujore dhe vjetore dhe sipas kërkesave të mbikëqyrësit;
9. Merr pjesë në seminare, trajnime dhe konferenca, në suaza të trajtimit të çështjeve nga fusha e përgjegjësisë të vendit të punës;
10. Kryen edhe detyra të tjera, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe.

**Kualifikimet dhe shkathhtësitë e kërkuara:**

- Diplomë universitare, në fushën e filologjisë (gjuhë dhe letërsi shqipe);
- Së paku 3 (tri) vjet përvojë përkatëse profesionale në redaktim/lekturë;
- Trajnime përkatëse;
- Vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për veprë penale, jo më i vjetër se 6 muaj.

**Procedura e konkurimit**

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org).

Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me konkurs personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Migjeni“, nr. 21, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës elektronike në adresën [zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org](mailto:zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org), si dhe me anë të shërbimit postar.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për veprë penale.

**Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga pjestarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 14 qershor 2018, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët që kanë aplikuar, por nuk janë përzgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit. Dokumentet që nuk tërhiqen administrohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782.